



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

**PROCESVERBAL<sup>1</sup>**

**(I përmbledhur)**

Tiranë, më 09.09.2019, ora 14.00

**Drejton mbledhjen**

**Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

**Rendi i Ditës :**

*1. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatës Zhaklina Peto për kandidimin e saj për dy vende vakante për Gjykatën Kushtetuese.*

*2. Diskutimi dhe vendimmarrja mbi ecurinë e deritanishme të procedurës së verifikimit dhe vlerësimit në lidhje me vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.*

**Marrin pjesë :**

- |                     |                     |
|---------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani   | (kryetar)           |
| 2. Vitore Tusha     | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku       | (anëtare)           |
| 4. Fatri Islamaj    | (anëtar)            |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare)           |
| 6. Fatjona Memçaj   | (anëtare)           |
| 7. Eriol Roshi      | (anëtar)            |

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plotë të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe të zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

**Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :**

1. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit Z. Enio Haxhimihali.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr.115/2016:**

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

## **HAPET MBLEDHJA**

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

**Ardian Dvorani** lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

*Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatës Zhaklina Peto për kandidimin e saj për dy vende vakante për Gjykatën Kushtetuese.*

*Diskutimi dhe vendimmarrja mbi ecurinë e deritanishme të procedurës së verifikimit dhe vlerësimit në lidhje me vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.*

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

**Anëtarët e Këshillit** miratojnë rendin e ditës së programuar.

**Këshilli vijon mbledhjen** me shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatës Zhaklina Peto për kandidimin e saj për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** informon se rreth dy orë para se të fillonte mbledhja kandidatja Zhaklina Peto ka sjellë një kërkesë drejtuar Këshillit, ne u përpoqëm tua sjellim anëtarëve menjëherë por koha ishte shkurtër, ndërkohë nga vetë kërkesa rezultoi që është vënë në dijeni edhe Institucioni i Presidentit të Republikës dhe Avokatit të Popullit. Në thelb kandidatja parashtron dy apo tre probleme: së pari, kërkon nga anëtarët e Këshillit të marrin në shqyrtim nëse janë pengesë ligjore për paanshmëri në këtë proces, me motivin që dy vendimmarrjet e tona të mëparshme pra vendimet nr.108 dhe 109 janë shfuqizuar nga Gjykata Administrative e Apelit dhe secili prej nesh ka pengesë ligjore apo ndodhet në konflikt interesi për ta trajtuar serish çështjen. Dhe së dyti parashtron disa argumente dhe i kërkon Këshillit ti drejtohet ILDKPI-së edhe njëherë për të bërë një hetim të plotë për të sjellë një raport dhe një relacion të dytë me arsyetimin se ajo nuk është subjekt i vlerësimit kalimtar dhe meqenëse deklaronte për herë të parë, motivet dhe gjetjet e ILDKPKI jo vetëm janë të pamjaftueshme, por nuk duhet të ishin bërë në këtë mënyre për një subjekt me cilësinë

e saj. Gjithsecili e ka këtë material, sikurse edhe relacionet që besoj u janë shpërndare të gjithëve. Znj. Arta, z. Eriol vijojmë me relatimin, bashkë me kërkesën apo si e vlerësoni ?

**Eriol Roshi**, në cilësinë e relatorit për vendin vakant, vakancë e përkohshme të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2019, shprehet se vlerëson të parashtrijë relatimin për çështjen.

**Eriol Roshi** parashtron relatimin për kandidaten Zhaklina Peto për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** duke falënderuar anëtarin relator për relatimin shprehet se përpara se të fillojmë me pyetjet sipas procedurës, sugjeron që të vijohet edhe me relatimin nga anëtarja tjetër e Këshillit relatorë për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2019, znj. Arta Marku.

**Arta Marku**, në cilësinë e relatores për vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2019, shprehet se në lidhje me parashtrimin e saj vlerëson të evidentojë se gjetjet janë të njëjtat dhe se nuk kam asgjë për ti shtuar asaj që relatoi hollësisht z. Eriol Roshi si anëtar relator për vakancën tjetër të kandidates Zhaklina Peto.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime për të dy relatorët e vakancave.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Enio Haxhimihali**, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se ne mbetemi të njëjtave gjera që kemi thënë në mbledhjet e kaluara kur është shqyrtuar kandidatura e kandidates në fjalë. Kështu që e vetmja e re ishte vendimi gjykatës pas të cilit Këshilli mori vendim për të rithirrur ekspertin dhe po presim që të shqyrtohet kërkesa e kandidates për të dhënë dhe opinion tonë. Por për sa i përket relatimit që u bë nuk kemi asnjë të veçantë nga ato që kemi thënë dhe në mbledhjet e kaluar kur është shqyrtuar kjo candidate.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** informon se sigurisht, së paku edhe sipas mendimit tim personal kur bisedohet çështja fillohet me kërkesën e kandidates, por sidomos me pikën e parë që kërkon kandidatja por kur të vijë momenti i bisedimit nëse ka pengesë ligjore apo jo. Megjithëse nuk e kemi formalisht të përcaktuar në procedure, unë nuk e besoj se ka ndonjë problem për ne që të dëgjojmë edhe mendimin e z. Dervishaj, meqenëse si gjithmonë është korrekt dhe prezent në mbledhjet tona.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën dhe parashtron se mbi relacionin nuk do të shprehem se është roli që i takon Avokatit të Popullit të mbajnë të qëndrim mbi gjetjet e themelit që parashtron relacioni. Por ndoshta kjo gjysmë e drejtë, do të thosha unë, vjen nga qenia personi i tretë në gjykimin

ku është vendosur shfuqizimi i vendimeve të Këshillit, ku ne mbartim detyrimet duke qenë palë në atë proces dhe kemi shprehur qëndrimin tonë. Më shumë do të çmoja të shprehesh mbi kërkimin e kandidatës, që i bie të jetë kërkesë paraprake. Unë vlerësoj, patjetër si përfaqësues i Presidentit të Republikës, se paraprakisht Këshilli do të duhet të marrë kërkimin nëse ndodhet në kushte të konfliktit të interesit, ndodhet apo nuk ndodhet, dhe sa i takon kërkimit të dytë që kandidatja kërkon edhe një here një vlerësim të thelluar nga ILDKPKI-ja, ne e mbështesim këtë kërkim. Po të studiohet me vëmendje, patjetër që është studiuar nga ju me vëmendje, shkresa jonë e disa ditëve më parë drejtuar Këshillit. Në thelb kërkohet pikërisht kjo gjë, vlerësimi i krahasuar i provave, që do të thotë provave që u formuan nga akti i ekspertimit, provave që u formuan nga depozitimi i kandidatës, provave nga vlerësimi i ILDKPKI dhe ti dërgohen edhe njëherë ILDKPKI, sepse ajo ngre këtu në këtë kërkim, pikërisht thotë “e cila duhet të bëjë një hetim të plotë të gjithë provave e të administrohen, burimit të krijimit të pasurisë dhe subjektet që kanë kontribuar në krijimin e tyre”. Kështu që edhe herës së kaluar kam bërë një parashtrere se disa nga subjektet që kanë kontribuar nuk kanë gjetur vlerësim nga ILDKPKI, kështu që unë mbështes kërkimin e kandidatës për rivlerësim nga ILDKPI mbi këtë çështje.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** duke e falënderuar për parashtrimin shprehet se ne do ta bisedojmë patjetër çështjen dhe sigurisht është një gjë e ditur, besoj, edhe ju duhet ta kuptoni, se diskutimi fillon me një kërkesë të kësaj natyre. Unë do të sugjeroj të kalojmë tek pika e dytë e rendit të ditës dhe të diskutojmë e vendosim për të dhe pastaj të procedojmë me tej.....

**Margarita Buhali** ndërhyr dhe shprehet se a do të marrim nga Avokati i Popullit ndonjë mendim për procedurën e konflikti të interesit që është pretenduar, meqenëse e dha edhe përfaqësuesi i Presidentit, në aspektin e kësaj kërkesë, të konflikti të interesit të KED sepse me duket se nuk e tha mendimin Avokati i Popullit.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** shpjegon se nuk jemi shprehur për këtë kërkesë, kur ta bisedojmë nëse eventualisht do ta gjejmë të drejtë, nuk vazhdojmë më tutje ose do këtë një zgjidhje tjetër që nuk e di tani. Mund ta thotë tani.

**Enio Haxhimihali**, merr fjalën dhe shprehet se nuk e parashtruar mendimin se nuk e kuptuar që ne do përjashtoheshim në momentin që do të shqyrtohej kjo kërkesë. Ne do të shprehim mendimin tonë pasi të shprehet Këshilli.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** shpjegon se nuk mund ta themi ne mendimin tonë në këtë moment, ky është problemi se jemi të penguar. Kështu që ne duam mendimin tuaj paraprak.

**Enio Haxhimihali**, merr fjalën dhe parashtron se kërkesa e kandidatës ka dy pika. Në lidhje me konfliktin e interesit, ne mendojmë që kjo kërkesë nuk është e saktë sepse ligji e parashikon edhe rastin çfarë ndodh kur gjykata e vendos për procedurë ta rikthejë për rishqyrtim organit

administrativ, KED në rastin konkret, dhe njëherë shqyrtimin e kandidates. Pra ligji nuk parashikon një organ tjetër apo nuk parashikon që ky është një rast i konfliktit të interesit. Përkundrazi ligji ka parashikuar se si vazhdohet më tej. Prandaj e kemi të qartë nga ana ligjore, mendojmë ne, se si duhet proceduar. Nuk është se ka një organ tjetër i cili mund ta shqyrtojë këtë kërkesë. I vetmi organ administrativ i cili mund të shqyrtojë këtë kërkesë. Në rast se gjykata e gjen të parregullt për procedurë, atëherë është i njëjti organ. Ne herën e kaluar kemi thënë që mund të merren masa të brendshme administrative për të mos u përsëritur këto probleme, por kjo nuk ka lidhje me kërkesën e kandidates.

Për sa i përket kërkesës se dytë, ne e kemi shprehur vazhdimisht mendimin tonë në lidhje me qëndrimin që duhet mbajtur kur kandidatet janë konstatuar me probleme nga ILDKPI-ja. Më konkretisht ka pasur 11 candidate që janë konstatuar me probleme nga ILDKPI. Ne si institucion kemi konstatuar se ligji nuk është i qartë në këtë rast. Pra me aktet e saj nënligjore KED nuk është se i ka dhënë një zgjidhje shteruese këtij problemi. Kështu që ILDKPKI ndodhet përpara një mbivendosje ligjesh, ajo për kandidatët që shqyrton në bazë të ligjit të saj organik ka një procedurë të caktuar ku i ridëgjon kandidatët në rast se konstaton problematika, gjë që nuk ndodh në rastin e kandidateve për organet e drejtësisë. E para afati shumë i shkurtër, vetëm 15 dite, që kandidati dorëzon kërkesën pranë ILDKPKI dhe me pas ILDKPKI nuk është se ka bërë shkelje ligjore që nuk ka thirrur kandidaten, por e përsërisim se ligji është i paqartë për këto raste. Pra për subjekte të cilat shqyrtohet në veprimtarinë e përditshme të ILDKPKI-së ka një procedurë tjetër. Pra për kandidatet siç jemi ne që deklarojmë prej shume vitesh në mënyrë të rregullt, ka një procedure të qartë. Por ka rezultuar, qoftë edhe nga praktika e organeve të vetingut, edhe ju vetë kryetar keni qenë një nga ata që keni thënë se nuk jeni thirrur nga ILDKPKI. Pra nuk është se ILDKPKI ka detyrimin për të thirrur candidate, ajo në rastin konkret ia përcjell KPK, KED gjetjet e saj dhe janë organet e tjera me teje që duhet të vazhdojnë. Këtë kemi ngritur ne si çështje më tej si do jetë unifikimi i procedurës nga KED dhe nuk kemi marrë përgjigje. Pra në 11 rastet dhe jo vetëm në rastet negative, por edhe pozitive, është bërë ky diskutim, në mbledhje madje ka qenë z. Bici që pyeti e bëri diskutim me ju kryetar a do i futemi rasteve kur ka një vendim të formës së prerë të organeve të vetingut etj.. Pra nuk ka një unifikim procedure si do të veprohet në rastet pozitive dhe negative kur ILDKPKI ka dhënë mendimin e saj. Për sa kohë legjislacioni është i paplotë, në vlerësimin tonë gjithmonë, mund të veprohet në të dy mënyrat, pra me teje të kërkohet prapë mendimi i ILDKPKI dhe të shohim çfarë reagimi do të ketë, sepse dhe ata nuk janë të detyruar, por as mund të refuzojnë ta marrin në shqyrtim. Por ne kemi bërë këtë rekomandim dhe herën e kaluar, dhe më parë, që mund të ridrejtohet KED-ja ILDKPKI-së për të riparë pretendimet e kandidatit. Ky është mendimi ynë në lidhje me pikën e dytë.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** shpjegon se faleminderit që ma kujtove rastin tim, e kam ngritur atë pretendime, është marre parasysh por ka një gjë që KPK nuk kërkoi të ribëhet akti nga ILDKPKI-ja por e vendosi vetë. Unë e kam ngritur këtë sepse ligji e parashikon si procedurë por ama KPK e shqyrtoj vetë rastin .

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** orienton mbledhjen në shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës, si vijim i diskutimit të ndërprerë sepse potencialisht ishte e mundur që një nga kandidatët mund të kishte një ankim administrativ dhe ne rast të një vendimi ndryshe nga vendimet tona të ndalimit mund të ndryshonte situata për sa i përket numrit të kandidaturave për vendin vakant të Inspektorit të lartë të Drejtësisë. Rezulton se nuk ka më ankime dhe asnjë komunikim nga ana e Gjykatës Administrative për raste ankimi për këtë vend vakant. Neni 147/d pika 4 e Kushtetutës përcakton që Këshilli i dërgon Kuvendit një liste prej 5 kandidatësh të përzgjedhur prej tij në mënyrë që Kuvendi të vijojë me procedurat e emërimit apo zgjedhjes së ILD-së. Nga ana tjetër, Kushtetuta por edhe ligjet nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur se çfarë do të ndodhte në situatën ku nëse ka një shpallje dhe një rishpallje dhe një tjetër numri i kandidaturave është më i vogël se 5 apo pas verifikimit kur numri ngelet më i vogël se 5, apo në përfundim të procedurave numri i kandidateve të lejuar mbetet përsëri më i vogël se sa 5. Në rast dakordësie për rishpallje, të diskutohet marrja e përgjegjësisë për të bërë të gjitha përpjekjet për ta mbyllur këtë proces dhe caktimi i një afati të shkurtër shpalljeje

**Margarita Buhali**, në cilësinë e relatores për vendin vakant, merr fjalën dhe shprehet se Kryetari e dha në mënyrë të detajuar gjithë rezymenë e asaj çfarë ka ndodhur me vendin e ILD. Është e vërtetë ajo që është një nevojë shumë e madhe për vendin dhe sa i përket ekzistencës së këtij institucioni. Por ne jemi përballë një fakti që numri është ulur nën minimumin e parashikuar nga Kushtetuta. Në fakt përballë kësaj situatë jemi gjetur edhe në Mars, ishte një diskutim i gjatë dhe në atë kohe kjo u reflektua edhe vendimin normativ nr. 4/2019 ku është e parashikuar deri në këtë moment qartazi se kur na zbret numri, ne duhet të kalojmë në pezullim dhe rishpallje, d.m.th dhe nuk ka asnjë alternative tjetër si mundësi. Kemi vetëm katër kandidatë të lejuar për kandidim dhe mund të caktohet një afat i shkurtër rishpalljeje vetëm për efekt të plotësimit të numrit 5 të kandidateve të lejuar.

**Anëtarët e Këshillit** diskutojnë për çështjen e rishpalljes së vakancës duke pasur parasysh parashikimet e Kushtetutës dhe të ligjit, si edhe rrethanën që ky institucion kushtetues nuk është funksional dhe nevojën për ta realizuar procedurën në kohën më të arsyeshme.

**Enio Haxhimihali**, merr fjalën dhe parashtron se mund të japim edhe ne mendim. Unë së pari jam i vlerësuar që institucioni jonë u përfshi në diskutimin e kësaj çështje. Ne kemi rekomanduar që dhe ne raste të tilla, i nderuar kryetar bëri një përmbledhje dhe kjo mund të jetë

fare mirë një relacion i përmbledhur që të na shpërndahet paraprakisht e që ne të kemi mundësi të përgatitemi më mirë. E treta për sa i përket përmbajtjes çështjes ne mendojmë se neni 147/d pika 4 i Kushtetues është i qarte dhe nuk ka vend për dy variante. Pra Kushtetuta ne rast analoge ka parashikuar se çfarë ndodh kur nuk plotësohet numri i nevojshme, parashikon votimin e dyte, të trete, çfarë ndodh me organin, shpërndahet si zgjidhet etj. Në rastin konkret neni 147/d pika 4 e Kushtetues nuk ka lënë një mundësi të tilla. Pra ka një kufi dysHEME që pa pasur 5 kandidatë nuk mund të procedohet me tej dhe në vlerësim tonë çdo interpretim i KED nuk do ishte në harmoni me këtë pike të Kushtetues. Në vijim për diskutimin për ta ndryshuar vendimin nr. 4/2019, ne mendojmë se neni 118 i Kushtetues nuk e lejon një gjë të tillë sepse thotë “aktet nënligjor e nxjerrën nën dhe për zbatim të ligjit. E nënvizoj, bëhet fjalë për Kushtetutën dhe jo për ligjin. Kur Kushtetuta nuk e ka autorizuar këtë apo ligji organik për të bërë një interpretim të tillë, në vlerësimin tonë duhet respektuar në dy aspekte neni i kushtetues. Së fundi, sa përket procedurave dhe afateve sigurisht nëse Këshilli do të zbatonte afate të tjera nga ato që ka miratuar dhe për ti paraprirë problemeve të tilla që mund të shfaqen, jo më kot që legjislatori ka parashikuar që pjesë e këtij organi të jetë dhe përfaqësuesi i Kuvendit. Ai ai fare mirë mund ta mbajë shënim, mund ta paraqesë me tej, por pse jo dhe KED në mungesë të përfaqësuesit të Kuvendit, mund ti drejtohet Kuvendit për të gjitha problematikat që kanë dalë dhe që kërkojnë ndryshimin e legjislacionit përkatës që do të lehtësonte punën qoftë të këtij organi, qoftë të KED në vitet e ardhshme.

**Bledar Dervishaj** merr fjalën dhe parashtrohet se absolutisht edhe ne jemi, në të njëjtin mendim me të gjithë anëtarët e Këshillit, e shprehen tashmë mendimin tyre. Me rënien nën numrit 5 të kandidatëve është nevojshme që ky numër duhet ti vejë Kuvendit që të ketë të drejtë zgjedhje, siç vete e ka vendosur në fund të ditës, Kuvendi ka thënë me duhen 5 kandidatë që të zgjedh Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Para tre mbledhjesh kemi pasur goxha debat mbi këtë çështje, kur unë vetë kam propozuar që, përveç vendimmarrjes se Këshillit që sot me sa duket po formohet që të ketë një rishpallje, të ketë edhe një njoftim për Kuvendin që pozicion vakant u rishpall, me qëllim që ato të vihen në dijeni të kësaj shtate problematike që mund të vazhdojë, shpresojmë që jo. Por që duhet ta ketë parasysh Kuvendi për ta lëvizur atë normë kushtetuese sepse u bënë 32 muaj vonese. Dhe ky shqetësim Kuvendit duhet ti kishte lindur vetë, nuk ka nevojë edhe të jetë prezent këtu. 32 muaj vonesë, ka një komision monitorimi që monitoron reformën, që nëse do të duhet se ky numër nuk po arrihet të zbresi në 3-4, sa ta vlerësoje politika, në fund të ditësvendimmarrje është ajo. Por që Këshilli duhet të vazhdojë me rishpallje dhe pezullim. E vetmja gjë që me të drejtë u ngrit dhe unë mbeshtes është diskutimi se a do të tërheqë relatori ekyistues edhe 4-5-6 aplikimet aq sa do të vijnë. Ndoshta do të duhet gjatë kohës që pas shpalljes Këshilli të bëjë një ndryshim, si ta vendosë Këshilli në rregullin e vetë. Edhe për katër kandidaturat që janë lejuar, ndoshta gjatë kësaj periudhe janë

kualifikuar edhe më shumë me certifikata dhe e kam merakun tek vlerësimi. Sepse kandidatët që vijnë rishtazi mund të jenë kujtuar gjatë kësaj periudhë me letra shtesë, ndërkohë që këto që kanë shprehur interesin kohë më parë mund të mos i kenë paraqitur. Në momentin e vlerësimit është edhe një tjetër gjë, mund të këtë masa disiplinore, ndonjë vërejtje sepse jemi tek kriteri moral.

*Anëtarët e Këshillit* vijojnë diskutimin dhe në përfundim të tij vendosin në mënyrë unanime të pezullojnë procedurën e verifikimit të kandidaturave për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe të shpalljen e procedurës së thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas tekstit që të rënë dakord dhe që i bashkëlidhet vendimit. Ndërsa paraqitja e interesit për kandidim, së bashku me dokumentacionin shoqërues, të depozitohet në zyrën e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pranë Gjykatës së Lartë, deri në datën 20 Shtator 2019. Ndërsa katër kandidatët e deritanishëm për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të cilët janë lejuar për kandidim me vendimet përkatëse të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, do të vijojnë të jenë pjesë e konkurrimit për plotësimin e këtij vendi vakant.

*Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani*, pasi evidenton që këto ishin çështjet e programuara për shqyrtim në rendin e ditës dhe deklaron mbylljen e mbledhjes.

#### **MBYLLET MBLEDHJA NË ORËN 15.40**

**Sekretare**

**Dorina Dulaj**

**Ermelinda Kadiu**

**Kryetari**

**Ardian Dvorani**